



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri

Raporti i Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së

20 shtator 2007

1. HYRJE

Që nga raporti i fundit i Prezencës para Këshillit të Përhershëm në qershor 2006, qeveria shqiptare i ka vazhduar përpjekjet për reforma në një klimë të polarizuar politikisht për shkak të marrëdhënieve të tensionuara midis koalicionit qeverisës dhe opozitës. Deri në fund të verës 2007, mosbesimi reciprok dhe mungesa e vullnetit të mirë midis protagonistëve u prinë ta ndërlikojnë debatin mbi reformat kryesore në vend dhe ta shmangnin fokusin nga çështjet thelbësore. Janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme legjislativë dhe sistemore, përfshirë vendimet për çështje kryesore fiskale dhe ekonomike, si edhe një paketë reformash në fushën e taksave, nga qeveria dhe rrjedhimisht nga Kuvendi, ku opozita shpesh ka bojkotuar duke protestuar, e ku koalicioni qeverisës është perceptuar si jo i gatshëm për të marrë parasysh pikëpamjet e kundërta ose alternative.

Qeveria u përqendrua tek rritja e të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe tek rritja e efikasitetit të administratës publike në përgjithësi, si dhe bëri përpjekje për të ecur përpara me projektet kryesore në infrastrukturë (përfshirë rrugët kryesore, prodhimin dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, sistemin e ujërave të bardha dhe atë të ujërave të zeza), si dhe ndoqi politikën e deklaruar në luftën kundër korrupsionit dhe krimit. Gjithashtu, i dha fund privatizimit të kompanisë shtetërore telefonike dhe u përgatit për një sërë privatizimesh të tjera në fushën e sektorit shtetëror të energjisë elektrike. Ka vazhduar t'u kalojë bashkive disa prej përgjegjësive në fushën e infrastrukturës, duke përfshirë edhe barrën e financimit. Qeverisë i është dashur të përballë me krizën energjetike të verës 2007 për shkak të një hendeku gjithmonë e më të madh midis rritjes së konsumit vendas në njërin anë dhe uljes së prodhimit në vend dhe kapacitetit të shtetit për të importuar energji elektrike nga jashtë në anën tjetër. Dy vjet pas ardhjes në pushtet, qeveria filloi të finalizojë një sërë strategjish sektoriale dhe ndërsektoriale, të cilat kanë qenë konsultuar me partnerë ndërkombëtarë. Për zhvillimin e përgjegjësive të saj planifikuese dhe menaxhuese, ajo është mbështetur në një Sistem Planifikimi të Integruar dhe ka vazhduar të konsolidojë kryesimin e saj si bashkërenduese e donatorëve.

Zgjedhjet lokale të shkurtit 2007, të cilat, sipas raportit përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, “u përputhën, vetëm pjesërisht, me angazhimet e OSBE-së”, u paraprinë nga negociata politike të tensionuara, me përfshirje ndërkombëtare, dhe u pasuan nga një periudhë e tejjzgjatur gjykimi ankimimesh paszgjedhore, me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në qershor 2007. Zgjedhja e Presidentit të ri nga Kuvendi më 20 korrik 2007 - ngjarja

kryesore më e fundit e periudhës mbi të cilën po raportohet – u bë brenda kufijve të procedurave kushtetuese dhe pa ndërmjetësim ndërkombëtar. Këto ngjarje kanë vonuar gjithashtu arritjen e rezultateve thelbësore në procesin e reformës zgjedhore.

Prezenca e OSBE-së ka vazhduar të konsultohet nga afër me autoritetet shqiptare dhe partnerë të tjerë për veprimtaritë e saj (përfshirë edhe projektet) dhe vazhdon të marrë parasysh përparësitë e qeverisë duke kërkuar përputhshmëri me punën e partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. OSBE/ODIHR-i ka dërguar misione vëzhgimi si afatgjata ashtu edhe afatshkurtra për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të cilave Prezenca u ka siguruar mbështetje lokale. Vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Ambasadorit M. de Brichambaut më 9-11 prill 2007 i dha shtysë punës së Prezencës në projektet kryesore dhe kontribuoi më tej në marrëdhëniet me vendin pritës. Asambleja Parlamentare e OSBE-së dërgoi në Shqipëri Raporterin e saj për Buxhetin dhe Menaxhimin, Dr. P. Blondal më datat 9-12 korrik 2007.

2. NGJARJET KRYESORE POLITIKE

Zgjedhjet kanë qenë një çështje dominuese gjatë gjithë kësaj kohe. Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore u vu për herë të parë në punë më 19 janar 2006 (pas shtyrjes së mandatit nga dhjetori 2005) dhe një tjetër Komision i Posaçëm u krijua më 18 maj 2006 për të rishikuar Kodin para zgjedhjeve të qeverisjes vendore. Afati i tij u shty vazhdimisht, pasi puna e tij u bllokua nga mungesa e një dialogu midis koalicionit qeverisës dhe opozitës si dhe nga divergjencat mbi përdorimin e regjistrave të përkohshëm të shtetasve si një nga burimet për hartimin e listave të zgjedhësve, afatet kohore për hartimin e tyre, dhe mbi vetë datën e zgjedhjeve. Mandati i fundit i Komisionit të Posaçëm skadoi më 14 nëntor 2006 pa miratuar asnjë ndryshim në Kodin Zgjedhor. Për të kapërcyer këtë ngërç, u arrit një marrëveshje dypalëshe mbi përdorimin e certifikatave të lindjes për zgjedhje, e cila u pasua nga një pakt tjetër më i gjerë që u arrit në një tryezë të rumbullakët nën kujdesin e Presidentit më 12 janar 2007. Ky pakt çoi në miratimin nga Kuvendi të disa ndryshimeve në Kushtetutë dhe Kodin Zgjedhor më 13 janar 2007, ndryshime të cilat u miratuan posaçërisht për t'u përdorur në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Për ta mbështetur këtë proces, në Shqipëri u dërgua një i Dërguar i Posaçëm i Kryetarit spanjoll të Radhës së OSBE-së. Data e zgjedhjeve, e caktuar fillimisht për në janar 2007, përfundimisht u shty për në 18 shkurt 2007.

Marrëveshja e vonuar mbi disa ndryshime në Kodin Zgjedhor, e cila u arrit vetëm 35 ditë para ditës së zgjedhjeve ndikoi tek përgatitjet zgjedhore. Vetë dita e zgjedhjeve kaloi përgjithësisht qetë, pa incidente të mëdha, ndonëse numërimi i votave i tejkaloi afatet ligjore. Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për këto zgjedhje, i publikuar më 14 maj 2007, megjithëse theksonte një lloj progresi të arritur në këto zgjedhje, rreshtonte edhe një sërë mangësish. Një proces gjyqësor paszgjedhor mbi procedurat dhe rezultatet rezultoi në dy raunde përsëritjesh, të cilat detyruan shpalljen e rezultateve përfundimtare vetëm më 8 qershor 2007. Dy palë zgjedhje të pjesshme parlamentare që u zhvilluan më 11 mars dhe 17 qershor 2007 u fituan nga Partia Demokratike. Megjithëse u mbajtën mes një klime të polarizuar, ato u

zhvilluan kryesisht qetë, ku mbi parregullsitë veproi KQZ-ja. Një tjetër zgjedhje e pjeshme parlamentare është planifikuar në një nga zonat zgjedhore të Tiranës më 23 shtator 2007.

Pas Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it, Kuvendi ngriti një tjetër Komision të Posaçëm me qëllim përfundimin e reformës para zgjedhjeve parlamentare të radhës në vitin 2009. Procesi i zgjedhjes së Presidentit, i cili filloi në qershor 2007 i kufizoi mundësitë për një përparim thelbësor. Komisioni i Posaçëm u mblodh dy herë dhe diskutoi, pa dalë në ndonjë përfundim, rreth disa çështjeve kyçe të reformës para se t'i skadonte mandati gjatë pushimit të gushtit 2007. Komisioni mund të mblidhet në shtator 2007 për të shqyrtuar fillimisht sistemin zgjedhor.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme politike ka qenë edhe procesi i zgjedhjeve presidenciale i përbërë prej pesë raundesh votimi brenda një muaji para përfundimit të mandatit të Presidentit në detyrë. Në fund të qershorit 2007, mungesa e një shumice të cilësuar (84 vota) bëri që dy takimet e para të votimit (duke pasur një kuorum të diskutueshëm) të mos zgjidhnin dot një kandidat. Atëherë, opozita e bojkotoi takimin e tretë të votimit në përgjigje të lidhjes që i bëri shumica qeverisëse marrëveshjes, me heqjen e Prokurorit të Përgjithshëm – që ishte kërkuar nga qeveria që në vjeshtë 2005. Pas rënies dakord të Kuvendit mbi mënyrën e llogaritjes së takimeve të votimeve, raundi i dytë i pakundërshtuar i votimit u zhvillua më 10 korrik 2007, por përsëri opozita e bojkotoi procesin. Më 14 korrik 2007, raundi i tretë përfundoi me eliminimin nga gara të një prej dy kandidatëve të opozitës, ku shumica e deputetëve të opozitës nuk ishin të pranishëm. Në raundin e katërt, më 20 korrik 2007, votat e gjashtë deputetëve të opozitës e lejuan kandidatin e shumicës qeverisëse Bamir Topi të merrte 85 vota, duke e kaluar me një votë kufirin e shumicës së cilësuar. Në procesin e zgjedhjeve presidenciale nuk pati ndonjë ndërmjetësim nga jashtë, që shpresohet të shënojë ndarjen nga praktikat e kaluara.

Në fushën e medias, pas arritjes së një marrëveshjeje politike në gusht 2006, Kuvendi miratoi një ligj që rriste numrin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), si edhe Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit Shqiptar (KDRTSH). Më 28 maj 2007, Kuvendi miratoi një ligj për transmetimet numerike. Ky ligj nuk u nënshkrua nga Presidenti, por megjithatë hyri në fuqi (për shkak të skadimit të afatit ligjor të veprimit nga ana e Presidentit). Megjithëse ky ligj u përshëndet si nga Komisioni Evropian, ashtu edhe nga Këshilli i Evropës, mundësia e KKRT-së për ta zbatuar këtë ligj pa një plan të përditësuar frekuencash analoge, mbetet një shqetësim. Me ndihmë ndërkombëtare ka nisur rishikimi i plotë i ligjit për mediat elektronike.

Në maj 2007, KKRT-ja filloi një fushatë për mbylljen e transmetuesve të paligjshëm të operatorëve rajonalë (të cilët kishin vite që transmetonin përtej zonave të tyre të autorizuar), por pa ndërmarrë ndonjë veprim mbi operatorët me licencë kombëtare, që nuk përmbushnin termat e kërkuar. Operatorët e prekur nga kjo fushatë e akuzuan KKRT-në për një përqaasje selektive të përqendruar kryesisht tek ata operatorë që ishin kritikë ndaj qeverisë. Një tjetër polemikë e lidhur me median u krijua kur një grup kryesor mediatik – transmetimet numerike të të cilit njihen si të palicencuara – u bë

shënjestër e kontrolleve të zyrës së taksave dhe u gjobit më vonë me rreth 11 milionë Euro për evazion tatimesh. Një pjesë e komunitetit të medias dhe opozita protestuan, dhe kjo e fundit edhe i akuzoi autoritetet për njëanshmëri politike. Qeveria e justifikoi këtë lëvizje me nevojën për të ndërmarrë veprime të fuqishme kundër transmetimeve të paligjshme dhe evazionit të tatimeve. Kjo periudhë solli ndryshime të mëdha në pronësinë e mediave elektronike në veçanti, ku një pjesë nuk kanë qenë mjaftueshëmrisht transparente dhe janë pasuar nga hetime dhe procese gjyqësore midis palëve.

Në fushën e reformës gjyqësore, çështja më e dukshme ka qenë ajo e një zëvendësimi të mundshëm të Prokurorit të Përgjithshëm, Th. Sollaku, i cili ka kohë që akuzohet nga shumica qeverisëse për mosndjekje penale e madje mbrojtje të kriminelëve. Më 25 korrik 2006, Kuvendi votoi për t'i rekomanduar Presidentit shkarkimin e tij, pas një komisioni të diskutueshëm hetimor. Opozita e bojkotoi votimin, duke e parë këtë çështje si të motivuar politikisht dhe të mbushur me parregullsi teknike. Më 13 tetor 2006, Presidenti Moisiu e hodhi poshtë këtë mocion duke thënë se ishte i pavërtetuar. Që me zgjedhjen e Bamir Topit President, janë rishfaqur thirrjet për zëvendësimin e Prokurorit të Përgjithshëm, nëpërmjet dorëheqjes, shkarkimit ose mbarimit të mandatit. Nga fundi i korrikut 2007, përfaqësuesit e qeverisë dhe koalicioni qeverisës kërkuan rihapjen e dosjeve të kryera gjatë trazirave të 1997-ës; kjo u pasua me arrestimet dhe akuzat e para. Opozita ka shprehur shqetësime se hetimet mund të jenë të motivuara politikisht dhe se mund të përdoren për ta zhvendosur vëmendjen nga kriza energjetike apo dështime të tjera të supozuara të qeverisë.

Ndryshime të rëndësishme u miratuan në Ligjin për Policinë e Shtetit nga Kuvendi më 4 qershor 2007. Ato u përgatitën me asistencë ndërkombëtare dhe përcaktuan standardet për menaxhimin, procedurat administrative dhe policinë në komunitet, si dhe hodhën bazat për një ristrukturim të përgjithshëm dhe zvogëlim të ndërhyrjeve politike. Opozita e bojkotoi votimin në Kuvend, duke e parë ligjin e ri si të dëmshëm për Policinë e Shtetit. Një ristrukturim i kësaj të fundit rezultoi në shkurtimin e 800 vendeve pune në korrik 2007. Opozita tha se kjo ishte pjesë e një skeme për të politizuar 9700 efektiva policie. Mangësitë në transparencë për marrjen dhe shkarkimin nga puna vazhdojnë. Një sërë efektivash me përvojë (shumë prej të cilëve të trajnuar nga misionet ndërkombëtare të policisë) u zëvendësuan nga njerëz, përvoja e të cilëve nuk është shumë e njohur. Megjithatë, në fund të korrikut 2007, qeveria pranoi se të shkarkuarit mund të rimerreshin në punë brenda forcave të policisë.

Në luftën kundër korrupsionit, megjithëse ka pasur rezultate të dukshme në ndjekjen e sjelljeve të korruptuara në jetën publike, në fakt nuk ka pasur shumë akuza të profilit të lartë. Shumica qeverisëse pretendon se kjo ka ardhur si pasojë e mosveprimit të Prokurorit të Përgjithshëm aktual. Në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës dhe armëve, numri i arrestimeve dhe sasive të kapura ka tendencë rritjeje. Në luftën kundër kultivimit në vend të drogave të paligjshme, policia ka raportuar kapjen e sasive më të mëdha të bimëve *cannabis*. Efekti real i masave të tjera të marra më parë kundër trafikimit të drogës, si ndalimi i skafeve, mbeten për t'u vlerësuar përfundimisht.

Për sa i përket reformës së pronës, qeveria ka ecur përpara gjatë kësaj periudhe raportuese. Në korrik 2006, Kuvendi ka miratuar disa ndryshime në Ligjin për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të cilat e rritën sipërfaqen e tokës bujqësore të disponueshme për kthim, krijuan një fond kompensimi, shkrinë ish Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe krijuan Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Ligji i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave u ndryshua në nëntor 2006 duke e lejuar Agjencinë (si pasardhëse të Komitetit) të rishikojë ankimet e pazgjdhura të depozituara kundër vendimeve të marra nga ish Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave.

Ligji për Legalizimin, Planifikimin Urban dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje miratuar në prill 2006 filloi të zbatohet për një numër më të madh kërkesash legalizimi sesa parashikohej. Në qershor 2007 qeveria miratoi disa ndryshime në këtë ligj, duke rregulluar disa afate kohore dhe procedura të procesit të legalizimit. Në korrik 2007, Agjencia për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave Informale (ALUIZNI) dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) ranë dakord të bashkërendonin legalizimin dhe regjistrimin e pasurisë së paluajtshme. Procesi i kthimit dhe kompensimit ka ende për të përfituar nga legalizimi, pasi krijimi i një fondi fizik kthimi kërkon përfundimin e një inventari të pasurive të paluajtshme shtetërore dhe fondi financiar i kompensimit duhet të mbështetet financiarisht me tarifa legalizimi. Fakti që nuk është përpunuar asnjë kërkesë e vetme për legalizim (nga më shumë se 200 mijë kërkesa të depozituara) vjen, sipas qeverisë, nga periudha e stërzgjatur e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Prishje demonstrative të një sërë ndërtimeve të paligjshme janë bërë edhe në zonën bregdetare. Në fund të vitit 2006 u përgatit një projekt në shkallë vendi për fotografimin nga ajri, i cili u prezantua në vitin 2007 dhe është ende në proces.

Në kuadrin e reformës ekonomike, qeveria ka prezantuar ndryshime rrënjësore në legjislacionin e tatimeve – ajo ka përgjysmuar detyrimin e tatimit mbi të ardhurat në gjysmën e vitit fiskal 2007 dhe ka shkuar drejt një tatimi të sheshtë mbi të ardhurat në vitin 2008. Që nga 1 gushti 2007, rrogat e të punësuarve si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, taten në një shkallë të sheshtë prej dhjetë për qind. Një nga polemikat politike u ngrit pikërisht rreth ndryshimeve në ligjin “Për procedurat e tatimeve” miratuar nga Kuvendi në prill 2007, i cili u kërkon bizneseve që të parapaguajnë një përqindje të caktuar të gjobave para ankimimit të vendimeve të administratës tatimore. Opozita pati kundërshtime rreth potencialit për një penalizim politik selektiv të bizneseve dhe Presidenti e ktheu ligjin për rishikim në Kuvend duke vënë në pikëpyetje përputhshmërinë e tij me Kushtetutën dhe të drejtën për një proces të drejtë ligjor. Në qershor 2007, Kuvendi vendosi ta rimiratonte këtë ligj.

3. BASHKËPUNIMI PËR SIGURINË

Prezenca ka vazhduar të ndihmojë Policinë e Shtetit dhe atë Kufitare, duke u përqendruar tek trajnimi në projektet e saj kryesore të planifikuara, por duke iu përgjigjur gjithashtu edhe kërkesave për mbështetje si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel rajonal.

3.1. Policia e Shtetit

Është ofruar ekspertizë dhe këshillim së bashku me misionin në ndihmë të policisë të BE-së (PAMECA) në me ICITAP-in për Ligjin për Policinë e Shtetit dhe ristrukturimin e policisë gjatë gjithë periudhës raportuese. Prezenca ka printuar 2000 kopje të ligjit të ri për trajnimin e Policisë së Shtetit në 12 Drejtoritë e Policisë.

Prezenca e ka mbështetur Policinë e Shtetit në zbatimin e strategjisë së saj në luftë kundër kultivimit të *cannabis sativa*-s. Nga prilli deri në qershor 2006, debatet publike kanë sjellë së bashku ata që prek ky kultivim, si edhe janë shpërndarë materiale informuese dhe janë transmetuar spote televizive për rritjen e ndërgjegjësimit. Së bashku me Policinë e Shkodrës dhe degën lokale të OJF-së “Malteser” në Shkodër, Prezenca nisi një projekt të rojes bregdetare në plazhin e Velipojës në qershor 2006. Deri në fund të projektit në shtator 2006 pati gjithsej 21 ndërhyrje që rezultuan në shpëtimin e 20 personave. Në gusht 2006, Prezenca në bashkëpunim me Njësinë për Çështjet Strategjike të Policisë të OSBE-së në Vjenë zhvilloi seminare në Vlorë për policinë kufitare dhe sektorët rajonalë të krimit të organizuar për ndjekjen e rasteve të trafikimeve të qenieve njerëzore pa dëshminë e viktimës.

Nga fundi i nëntorit 2006, Prezenca dhe Instituti Turk i Policisë siguruan një trajnim për menaxhimin e hetimeve të trafikimit të drogave të paligjshme. Në prill 2007, Prezenca filloi një projekt për rritjen e kapacitetit të Policisë së Shtetit në teknikat hetimore dhe të marrjes në pyetje. Ky projekt ndihmoi në zhvillimin e programit mësimor të Akademisë së Policisë, ndërsa një ekspert ndërkombëtar ndihmoi në trajnimin e drejtorive të policisë. Trajnimi u zhvillua bashkë me PAMECA-n, ICITAP-in dhe Akademinë e Policisë.

Prezenca ka mbështetur tre projekte për rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë rrugore. I pari u bë gjatë Javës Kombëtare të Ndërgjegjësimit të Sigurisë Rrugore në nëntor 2006. Projekti u krye nga Policia, ministritë, PAMECA dhe OJF-të lokale. Prezenca botoi 1600 broshura për sigurinë rrugore, që u shpërndanë nga Policia e Shtetit, dhe 25000 shoferë u kontaktuan dhe iu dhanë fletëpalosje. Veprimtaria e dytë u zhvillua gjatë Javës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Sigurinë Rrugore në prill 2007, ku Prezenca siguroi materiale të printuara për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve për përdorimin e rripit të sigurimit dhe rreziqet e konsumimit të alkoolit në drejtimin e automjetit. Bashkë me OJF-të lokale, Prezenca trajnoi 200 efektiva të policisë rrugore për ofrimin e ndihmës së shpejtë viktimave të aksidenteve rrugore dhe iu dhuruan 60 paketa të ndihmës së shpejtë automjeteve të policisë rrugore. Veprimtaria e tretë për sigurinë rrugore ishte një fushatë informimi në korrik 2007 në pikat e kalimit të kufirit për t’u kujtuar turistëve që hynin në Shqipëri që t’u përmbaheshin rregullave të qarkullimit rrugor.

3.2. Policia Kufitare

Në vitin 2006 Prezenca përfundoi një projekt që konsistonte në sigurimin e disa paneleve diellore Departamenteve të Policisë dhe pikave të kalimit të kufirit, në mënyrë

që ato të furnizohen me energji elektrike pa ndërprerje. Gjithsej, Prezenca instaloi dhe dhuroi nga projekti i saj me fonde jashtë buxhetore 8 gjeneratorë që prodhojnë energji diellore. Prezenca, pas dhurimit të radiove UHF, përsëritësve, gjeneratorëve diellorë dhe kompjuterëve, i dhuroi Policisë së shtetit edhe pajisje për vëzhgimin e kufirit, ku përfshiheshin pajisje shumë cilësore për survejimin e kufirit gjatë natës, të cilat u siguruan pas mbylljes së Misionit të Operacionit të Monitorimit të Kufirit në Gjeorgji. U mundësua edhe një sasi tjetër pajisjesh përmes dhurimit nga Shtetet e Bashkuara të disa kompjuterëve për rritjen e efektshmërisë së operacioneve të policisë kufitare, dhe për ta ndihmuar veçanërisht policinë në proceset e saj raportuese. Përveç kësaj, Prezenca po punon me Drejtorin e Policisë Kufitare për të ngritur një Njësi Mbështetëse Kufitare të lëvizshme, dhe me kërkesë të tyre, shumë shpejt në Shqipëri do të mbërrijë një ekspert për të bërë vlerësimin e fizibilitetit.

Në janar 2007, Prezenca, së bashku me PAMECA-n dhe Forcat e Kosovës (KFOR) lehtësuan transportimin e dy zyrave tip kontenieri për në Pikën e Kalimit të Kufirit në Shishtavec dhe Orgjost. Pas problemeve me transportimin ajror, Prezenca negocioi me *KFOR MNB South* duke siguruar një kontenier të përkohshëm për Shishtavec në më 26 janar 2007. Më vonë, ky kontenier u zëvendësua në mars/prill. Për Pikën e Kalimit të Kufirit në Orgjost, një kontenier u transportua nga ajri nga KFOR-i në një operacion më 11 maj 2007. Dy zyrat fillestare tip kontenieri u transportuan për në Pikën e Kalimit të Kufirit në Qafë Morinë për të zgjeruar ambientet e punës atje.

Me kërkesë të Policisë Kufitare dhe Migrimit, Prezenca filloi në maj 2007 në Shkodër një projekt pilot, i cili siguroi trajnime për patrullimin me kuaj të kufirit.

Gjatë periudhës raportuese, takime për bashkëpunimin ndërkufitar janë zhvilluar me Kosovë/Serbinë, Malin e Zi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në shtator 2006 u zhvilluan tetë takime trepalëshe midis Shqipërisë, Kosovë/Serbisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në Kukës me pjesëmarrjen e qeverisjes vendore dhe përfaqësuesve të OSBE-së.

Në kufirin me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë u mbajt një seminar me pjesëmarrjen e ekspertëve të lartë të Policive të Kufirit nga të dy vendet. Takimi u përqendrua tek strategjitë aktuale për bashkëpunimin dhe menaxhimin e kufirit dhe eksploroji modalitete të reja me qëllim luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar. Kjo veprimtari u pasua nga një takim bashkërendues midis Prezencës dhe Misionit të OSBE-së në Shkup. Në kufirin me Republikën e Malit të Zi, tre takime u mbajtën në Shkodër, Podgoricë dhe Tiranë përkatësisht nga Prezenca dhe Misioni në Malin e Zi. Si rezultat i këtyre takimeve, u hartuan dy dokumente dhe iu dërguan Ministrisë së Drejtësisë në të dyja vendet për miratim përfundimtar. U lehtësua edhe një Takim Ndërkufitar rajonal me zyrtarët e Policisë Kufitare në Shkodër.

Prezenca vazhdoi me lehtësimin e takimeve të rregullta të bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovë/Serbinë. Takime të përdyjavshme janë mbajtur në pikat e kalimit të kufirit në Morini-Vrbnica, Qafa e Prushit dhe Qafë Morinë. 62 takime të përdyjavshme janë lehtësuar me pjesëmarrjen e zyrtarëve të sigurimit dhe doganave, Shërbimit Policor të Kosovës, KFOR-it, Policisë së Shtetit shqiptar dhe UNMIK-ut. Po kështu, janë mbajtur takime të përmuajshme në Gjakovë, Dragash dhe Prizren (Kosovë/Serbi), si edhe në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Kukës. Si rezultat i takimeve ndërkufitare të

lehtësuara nga Prezenca midis KFOR-it, Shërbimit Policor të Kosovës dhe Policisë së Shtetit shqiptar, patrulla të sinkronizuara kufiri u inauguruan më 11 maj 2007 në anën shqiptare të pikës së kalimit të kufirit nga këmbësorët në Krushevo/Shishtavec. Një takim për Bashkëpunimin mes Komuniteteve Ndërkufitare u lehtësua midis komuniteteve të Pakishtit (Shqipëri) dhe Krstac/Dragashit (Kosovë/Serbi) për të nxitur bashkëpunimin dhe për të ndërmarrë masa të përbashkëta parandaluese para sezonit të verës kundër veprimtarisë së paligjshme kufitare. Të dy komunitetet ranë dakord që të zhvillojnë takime të përmuajshme gjatë sezonit të verës.

4. QEVERISJA NË ÇËSHTJET EKONOMIKE DHE MJEDISORE

Ky program përqendrohet tek qeverisja në çështjet ekonomike dhe mjedisore, duke përfshirë qeverisjen vendore dhe reformën territoriale administrative, reformën e pronave, luftën kundër pastrimit të parave, si edhe aspektet jopolicore të anti-trafikimit.

4.1. Reforma e pronave

Në vitin 2006, Prezenca u konsultua me qeverinë dhe agjencitë e saj për një strategji që do të lidhte regjistrimin fillestar të pronës, kthimin dhe kompensimin e saj me legalizimin e pronave informale. Në vitin 2007, Prezenca sugjeroi se si mund të lidheshin këto procese për të arritur në të njëjtën kohë legalizimin dhe regjistrimin e pronës, si edhe për mënyrën se si mund të menaxhoheshin të dhënat e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave me qëllim që procesi i kthimit të mund të përfitonte nga të ardhurat e gjeneruara përmes procesit të legalizimit, siç parashikohet me ligj.

Në vitin 2007, Prezenca është në procesin e përfundimit të mbështetjes së saj për procesin e regjistrimit fillestar të pronës në bashkëpunim me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i cili rezultoi në regjistrimin fillestar të 24000 pronave në Vlorë dhe Tiranë. Prezenca punoi edhe në dy zonat më të mëdha joformale për të zhvilluar një plan pune në ndihmë të qeverisë për të arritur një regjistrim dhe legalizim të bashkërenduar të pronës. Projekti pilot është përpjekur të regjistrojë dhe legalizojë mbi 9000 prona në vitin 2007. Në verën e vitit 2007, Prezenca dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave përfunduan një projekt për kompjuterizimin e të gjitha të dhënave të kërkesave për kthim dhe kompensim që nga viti 1994. Gjatë këtij projekti u dixhitalizuan mbi 43000 dosje dhe kjo bazë të dhënash i ka siguruar për herë të parë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave mundësinë për të siguruar statistika mbi procesin e kërkesave. Kjo bazë të dhënash do ta ndihmojë qeverinë për të menaxhuar më mirë procesin e kthimit dhe kompensimit dhe për ta harmonizuar atë me legjisllacionin.

4.2. Reforma rajonale

Më 29 maj 2007, Prezenca, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Ministrinë e Brendshme, mbajti një tryezë të rrumbullakët për reformën e qeverisjes rajonale. Prezenca dhe Këshilli i Evropës rishikuan modelet përkatëse për t'u ofruar pjesëmarrësve disa variante për t'i ndjekur në kuadrin e reformës rajonale administrative. Mbi këtë bazë, Prezenca do ta ndihmojë qeverinë për të përgatitur një plan të reformës rajonale në përputhje me Planin Kombëtar të Punës. Prezenca ka

zbatuar disa projekte me kryetarë të 14 organeve të qeverisjes vendore për të forcuar planifikimin strategjik, si edhe shkallën e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve. Në fund të korrikut 2007, Prezenca zhvilloi një veprimtari promovuese për të mbështetur nëntë kryetarët e bashkive në vend që dolën nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në shkurt 2007. Ky program siguron një platformë ku kryetarët e bashkive dhe komunave mund të ndajnë përvojën e tyre me gra të tjera drejtuese për të rritur profilin e tyre dhe për t'i fuqizuar ato në çështje publike, si edhe për trajnimin dhe mbështetjen e tyre materiale, të cilat po përgatiten për t'u zhvilluar në fund të vitit 2007.

4.3. Qeverisja e mirë

Në prill 2007, Prezenca organizoi një konferencë rajonale kundër korrupsionit, financuar nga OSBE-ja dhe Iniciativa e Paktit të Stabilitetit kundër Korrupsionit për zyrtarë publikë dhe të shoqërisë civile nga vendet e rajonit. Prezenca ka punuar për të rritur transparencën dhe qeverisjen e mirë në nivel vendor duke i ofruar 129 kryetarëve të sapozgjedhur të bashkive dhe komunave seminare për parandalimin e konflikteve të interesave. Prezenca e ka mbështetur Drejtorinë për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPP) për të përmirësuar efektshmërinë e mbledhjes së të dhënave përmes shpërndarjes në 12 bankat e nivelit të dytë të një programi kompjuterik në fushën e pastrimit të parave të projektuar nga OSBE-ja. Ky program është tashmë në funksionim në 17 banka të nivelit të dytë, duke rritur kështu efektshmërinë e shkëmbimit të të dhënave midis bankave dhe DPPP-së. Prezenca i ofroi mbështetje edhe kësaj drejtorie duke i dhuruar disa pajisje, trajnim për personelin në programin ORACLE për të përmirësuar administrimin e bazës së të dhënave, si edhe duke i siguruar një ekspert për hartimin e një raporti mbi vlerësimin e nevojave teknike. Në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit të Veprimtarive Ekomike dhe Mjedisore të OSBE-së në Vjenë (OCEEA), Prezenca mbajti gjashtë seminare dhe një konferencë rajonale mbi Kodin Global të Sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm si një masë parandaluese.

4.4. Reforma mjedisore

Në vitin 2006 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave mbi zbatimin e Konventës së Aarhusit. Në Tiranë u hap Qendra e Informimit Aarhus me pajisje të dhuruara nga Prezenca përmes një granti të Iniciativës për Sigurinë dhe Mjedisin. Një tjetër qendër e informimit Aarhus po hapet në Shkodër me nismën lokale të Prezencës. Qendra e Informimit Aarhus në Tiranë ka zhvilluar një takim me autoritetet qeveritare dhe OJF-të për sa i përket së ardhmes së një vend-grumbullimi mbetjesh urbane në Tiranë. Një OJF-je lokale në Sarandë iu dha një grant në bashkëpunim me Bashkinë për trajtimin e çështjeve të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta. U formua një grup i përbashkët planifikimi qytetarë-bashki për të siguruar pjesëmarrjen e publikut në çështjet e pastrimit. Ky projekt ishte lidhur me një fushatë kombëtare drejtuar nga Korporata Ndërkombëtare Financiare për të rritur ndërgjegjësimin për riciklimin e mbetjeve. Mbështetje i është siguruar Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe njësisë të qeverisjes vendore me veprimtari në Shkodër dhe Gjirokastër, të cilat kanë pasur për qëllim krijimin e një vend-grumbullimi mbetjesh urbane formal dhe miqësor për mjedisin.

4.5. Anti-trafikimi

Mbrojtja e të drejtave të njeriut të viktimave të trafikimit dhe ndihma në ri-integrimin e tyre shoqëror kanë mbetur përparësitë e Prezençës. Për ta arritur këtë, me ndihmën e Korporatës Austriake për Zhvillim, Prezenca ka trajnuar pesëmbëdhjetë gra dhe vajza, viktimat të trafikimit, për zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe u ka dhënë kredi të vogla fillimisht treve prej tyre. Për të përmirësuar mbrojtjen e viktimave të trafikimit, Prezenca ka mbështetur përpjekjet e qeverisë për të hartuar standardet e mbrojtjes sociale për viktimat e këtij lloji kriminaliteti që më pas do të pasohet me publikimin dhe shpërndarjen e gjithë dokumentacionit. Për të përmirësuar mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, Prezenca e ka mbështetur qeverinë në krijimin e një baze të dhënash për rastet e trafikimit.

Për të rritur bashkëpunimin ndërkuftar për çështjet e trafikimit, Prezenca ka mundësuar një takim midis autoriteteve shqiptare dhe atyre të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për të diskutuar një projekt-protokoll bashkëpunimi. Prezenca ka mbështetur një koalicion OJF-sh për të zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi kundër shfrytëzimit të fëmijëve për lypje. Si pjesë e projektit të ODIHR/OCEEA për Fuqizimin Ekonomik të Grave, Prezenca udhëhoqi një analizë të nevojave të tregut të punës dhe mundësive për punësim për gratë në veri të Shqipërisë. Në korrik 2007, Prezenca ka zhvilluar seminare për Edukimin Ligjor dhe Mbrojtjen e të Drejtave, aksesin për Drejtësi të personave të Trafikuar dhe grupeve të riskuara, mes të cilëve romët ishin grupi kryesor.

5. DIMENSIONI NJERËZOR

Prezenca është përqendruar tek reforma legjislativë dhe gjyqësore, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut, përfshirë barazinë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, reforma zgjedhore, përfshirë regjistrimin e zgjedhësve/shtetasve, forcimi i kapaciteteve parlamentare, puna me shoqërinë civile dhe zhvillimi i medias.

5.1. Reforma gjyqësore

Në nëntor 2006, Prezenca publikoi një analizë të Sistemit të Drejtësisë Penale dhe bëri rekomandime për përmirësimin e një sistemi më të drejtë dhe eficient. Seminaret e drejtuara nga Prezenca dhe Këshilli i Evropës për punonjësit e drejtësisë penale u përqendruan tek praktikat më të mira në fushën e arrestimeve dhe periudhën e paraburgimit. Në mars-prill 2007, Prezenca dhe Këshilli i Evropës, Shkolla shqiptare e Magjistraturës dhe një OJF lokale organizuan seminare për juristë dhe policë mbi Ligjin e Dhunës ndaj Gruas. Në maj 2007, Prezenca dhe PAMECA organizuan një seminar për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili u drejtua nga një ekspert nga Njësia gjermane e Mbrojtjes. Në të morën pjesë zyrtarë të Drejtorisë shqiptare për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunitorëve të Drejtësisë.

Prezenca dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë ofruan seminare për zyrtarët e sistemit të drejtësisë të tre qarqeve mbi të drejtat e pacientëve të sëmurë mendorë. Prezenca ka mbështetur Komisionin e Shërbimit Civil duke organizuar një vizitë në Institutin e Administratës Publike të Irlandës dhe duke kontribuar financiarisht në mirëmbajtjen e faqes së tyre të internetit. Në janar 2007, Prezenca redaktoi një udhëzues të Mbretërisë

së Bashkuar mbi përdorimin e ADN-së në procedimet penale për trajnimin e punonjësve ligjorë. Prezenca mbështeti hartimin e ndryshimeve në ligjin e vitit 2004 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

5.2. Të drejtat e njeriut

Prezenca financoi publikimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Romëve, e cila iu shpërnda njësisë të qeverisjes vendore, trajnoi mësues nga zonat pilot për të mbledhur të dhëna në lidhje me frekuentimin e shkollës nga fëmijët romë dhe ka financuar dy projekte për rritjen e ndërgjegjësimit mes komunitetit romë për të drejtën e votës. Së bashku me Avokatin e Popullit dhe Ambasadën Franceze në Tiranë, Prezenca zbatoi projektin mbi të Drejtën e Informimit, i cili konsistonte në promovimin e së drejtës për informim të dokumenteve zyrtare, çështjet mjedisore dhe të drejtat e të paraburgosurve. Prezenca trajnoi personelin e nivelit të lartë të Inspektoratit të Lartë të Punës mbi çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë. Prezenca vazhdoi të kryesojë takimet koordinuese midis donatorëve dhe qeverisë mbi të drejtat e romëve dhe çështjeve të reformës së burgjeve.

5.3. Reforma zgjedhore

Prezenca e ka mbështetur qeverinë në përgatitjen e listave të zgjedhësve për Zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore duke hartuar udhëzime dhe duke drejtuar seminare për përmirësimin e kuadrit ligjor. Në dhjetor 2006, Prezenca ofroi 100 kompjuterë me të drejtë përdorimi për regjistrimin e zgjedhësve. Prezenca e mbështeti Komisionin e Posaçëm parlamentar për hartimin e dispozitave për listat e zgjedhësve, duke u ofruar pajisje dhe mbështetje sekretariale. Prezenca mbështeti programin e trajnimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kontribuoi në rritjen e kapaciteteve në zyrat e tyre rajonale, si edhe duke printuar kopje të Kodit Zgjedhor dhe manualeve të qendrave të votimit dhe numërimit të votave. Prezenca ndihmoi edhe me fushata të informimit publik për sensibilizimin e zgjedhësve, fushata kundër votimit familjar dhe votimit në emër të zgjedhësve të tjerë, si edhe mbi përdorimin e dokumenteve të identifikimit për votim. Gjithashtu, Prezenca financoi edhe botimin e manualëve të qendrave të votimit dhe numërimit për KQZ-në. Në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të të Verbërve, Këshillin Kombëtar të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe KQZ-në, Prezenca siguroi mjete votimi për zgjedhësit e verbër në Tiranë dhe Durrës për zgjedhjet lokale. Para zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore u organizuan në bashkëpunim me PAMECA-n seminare për policinë mbi rolin e Policisë së Shtetit në zgjedhje dhe u botuan dhe shpërndanë 6000 libra xhepi për policinë. Në nivel lokal, Prezenca, në bashkëpunim me Rrjetin Kombëtar të Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile organizoi një sërë debatesh televizive gjatë fushatave të zgjedhjeve lokale duke sjellë bashkë kandidatët e partive të ndryshme politike në një ambient publik.

5.4. Modernizimi i Sistemit të Adresave dhe Regjistrimit të Gjendjes Civile

Në zbatim të rekomandimeve të ODIHR-it mbi Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të shkurtit 2007, Prezenca nisi një projekt në ndihmë të qeverisë shqiptare për krijimin e një sistemi adresash, modernizimin e sistemit të gjendjes civile, si edhe për të gjeneruar lista të besueshme zgjedhësish, për të përmirësuar kuadrin ligjor mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe për krijimin e një autoriteti të pavarur për

mbrojtjen e të dhënave personale. Në qershor 2007, projekti prodhoi raportin e parë me qëllim që qeveria të vepronte mbi konstatimet e tij. Projekti planifikohet të vazhdojë deri në fund të vitit 2009 dhe po zbatohet me financim kryesor të Komisionit Evropian, kontribute shtesë nga Shtetet e Bashkuara, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës dhe *Statistics Norway*.

5.5. Ndërtimi i kapaciteteve parlamentare

Prezenca ka vazhduar të punojë me Kuvendin nëpërmjet projektit të saj mbi “Modernizimin e Kapaciteteve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, faza e parë e të cilit mbaroi në vitin 2006. Prezenca u ka ofruar deputetëve dhe personelit të lartë të Kuvendit trajnim në fushën e medias me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre në marrëdhëniet me median dhe komunikimin me publikun. Takimi i tretë dhe përfundimtar i ekspertizës për Komisionin parlamentar për Integrimin Evropian dhe procesin e Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit u bë në bashkëpunim me një OJF vendase. Prezenca mbështeti blerjen e dy skanerëve *X-Ray*, të cilët lehtësojnë hyrjen e vizitorëve dhe garantojnë sigurinë e nevojshme, si edhe e ndihmoi Kuvendin në organizimin e trajnimeve për zyrat e deputetëve në zonat e tyre zgjedhore. Që nga fundi i vitit 2006, është negociuar me Kuvendin dhe donatorin rreth një propozimi për një projekt të ri tre-vjeçar, mbi të cilin më në fund u ra dakord dhe palët e nënshkruan në qershor 2007. Në përputhje me vetë programin e Kuvendit, projekti do të ofrojë asistencë në strukturat menaxhuese dhe vendimmarrëse, funksionimin e komisioneve parlamentare, komunikimin me zgjedhësit, aksesin e publikut në informacionin parlamentar, bibliotekën e parlamentit dhe programe praktikash mësimore. Ky projekt filloi në vitin 2007 dhe do të vazhdojë deri në dhjetor 2009.

5.6. Media

Së bashku me Institutin shqiptar të Medias dhe USAID-in u përditësua kodi i etikës së gazetarëve i vitit 1996 dhe u krijua një Këshill për Etikën në Media. Ky këshill përbëhet nga akademikë, regjisorë, shkrimtarë dhe ekspertë të medias. Prezenca mbështeti botimin dhe shpërndarjen e 2000 kopjeve të Kodit dhe kontraktoi një ekspert ndërkombëtar për të ofruar asistencë. Me kërkesë të Komisionit parlamentar të Medias, Prezenca ofroi informacion mbi mënyrën se si përdoret shumica e cilësuar në bordet rregullatore të medias në vende të tjera evropiane. Për të ndihmuar Komisionin, Prezenca dhe Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias drejtoi një vizitë studimore për deputetët shqiptarë mbi standardet e medias në Vjenë në janar 2007. Gjithashtu, Prezenca ka mbajtur kontakte me aktorë vendas dhe partnerë ndërkombëtarë për sa i përket Ligjit të Transmetimeve Numerike, i cili u miratua nga Kuvendi më 28 maj 2007 dhe ofroi disa komente joformale në muajin prill. Prezenca përfundoi edhe projektin “Trajnimi i Medias Lokale mbi Standardet Profesionale dhe Rritjen e Transparencës në lidhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit”, financuar nga qeveria zvicerane dhe organizata holandeze *Press Now*. U trajnuan 20 stacione televizive lokale dhe pesë më të mirët u vlerësuan me një çmim.

5.7. Shoqëria Civile

Prezenca vazhdoi të mbështesë Qendrat e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (QZSHC) duke ndjekur një plan disa-vjeçar për shtrirjen në nivel kombëtar të tyre. QZSHC-të

janë regjistruar në vitin 2006 si rrjete të pavarura kombëtare për të ofruar ndërtim kapacitetesh dhe shërbime për shoqërinë civile. Pavarësisht nga veçoritë e përbashkëta, profili i QZSHHC-ve lokale ndryshon nga njëra tek tjetra: rrjetet e shoqërisë civile në Kukës dhe Shkodër kanë monitoruar punën e kompanive të pastrimit; Bashkia Elbasan e ka kontraktuar QZSHHC-në lokale për të bërë një projekt për mundësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit. QZSHHC-ja e Vlorës është përqendruar tek çështjet mjedisore, kurse QZSHHC-ja e Shkodrës ka qenë partnerja lokale zbatuese në një projekt arsimor të Këshillit Britanik, ndërkohë që QZSHHC-ja e Korçës përfaqëson komunitetin e OJF-ve lokale në Komisionin lokal të Strehimit.

Prezenca ka punuar me qeverinë në mbështetje të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara duke ofruar ekspertë për forcimin e Sekretariatit Teknik, për hartimin e buxhetit të Planit Kombëtar të Veprimit, si edhe për të forcuar kapacitetin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta për të raportuar mbi zbatimin e Strategjisë.

5.8. Përkatësia Gjinore

Prezenca ka mbështetur kontributin e shoqërisë civile në rishikimin e Ligjit të Barazisë Gjinore të vitit 2004. Paketa e tyre e ndryshimeve iu dërgua qeverisë në prill 2007 dhe është në pritje të miratimit. Që nga shkurti 2007, Prezenca ka asistuar në proceset e hartimit dhe konsultimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore nëpërmjet angazhimit të disa ekspertëve në ndihmë të qeverisë. Vëmendja ndaj nevojave të grupeve të grave në veri të vendit ka mbetur në qendër të kujdesit duke siguruar fonde donatorësh për Qendrën e Këshillimit të Grave në Kukës deri në fund të vitit 2006. Kjo qendër, e cila u bë një organ i pavarur në shkurt 2007 i ka ofruar mbështetje grupeve të grave në rrezik.

6. NJËSIA E ADMINISTRIMIT TË FONDEVE

Kjo njësi ka vazhduar të mbështesë departamentet tematike në punën e tyre gjatë periudhës raportuese. Transferimi nga ambientet e vjetra në ambiente të reja, më të mira, më të sigurta dhe më ekonomike përfundoi gjatë periudhës raportuese – ky transferim u bë pa kosto shtesë në buxhet. Sistemi i Menaxhimit të Përbashkët Rregullator është tashmë në funksionim të plotë. Marrja në punë e personelit të ri ka vuajtur nga një numër në ulje të dërguarish nga vende të tjera, shumë prej të cilëve ose janë të papërshtatshëm, ose nuk kanë përvojë. Zëvendësimi i aseteve, sidomos atyre të rëndësishme dhe të shtrenjta, si i kompjuterëve dhe automjeteve, ka vazhduar të përbëjë një sfidë menaxhimi, pasi fondet janë shpërndarë sipas përparësive dhe janë përqendruar tek arritja e rezultateve të programeve tematike.

7. PUNA NË TË ARDHMEN

Planifikimi i Prezencës për vitin 2008 merr parasysh sfidat e reformave në vend dhe përparësitë e qeverisë. Ndonëse gama tematike e punës së planifikuar nga Prezenca përcaktohet nga mandati, përparësitë kryesore janë identifikuar nga qeveria: reforma zgjedhore, qeverisja e mirë dhe reforma e gjyqësorit. Viti 2008 do të jetë i rëndësishëm për Shqipërinë, ashtu edhe për Prezencën, pasi si një vit pa zgjedhje të planifikuara,

duhet të lejojë vëmendjen të përqendrohet tek reformat kyçe, të cilat janë thelbësore në kuadrin e ambicieve të qeverisë për integrimin në strukturat Euro-Atlantike. Zgjedhjet e ardhshme në horizont – Zgjedhjet Parlamentare të 2009-ës – e detyrojnë Shqipërinë të përqendrojë gjatë kësaj kohe gjithë energjitë dhe burimet e saj për të bërë përparime të prekshme në detyrat e reformave kryesore. Prezenca pritet të ndihmojë në disa prej tyre, si nëpërmjet mandatit të saj, ashtu edhe nëpërmjet fondeve që do t'i vihen në dispozicion për të mbështetur procesin e reformave.

Sigurimi nga OSBE-ja i një ekspertize dhe mbështetje teknike të mëtejshme nën drejtimin e ODIHR-it për reformën zgjedhore do të varet nga përmbajtja dhe ritmi i debatit në komisionin parlamentar për reformën zgjedhore. Në qoftë se aktorët politikë zgjedhin të ndryshojnë sistemin zgjedhor, detyra do të bëhet edhe më e madhe, ndoshta në mënyrë kritike, duke pasur parasysh afatet e zgjedhjeve parlamentare. Sidoqoftë, minimumi i nevojshëm do të duhet të përfshijë ndjekjen e rekomandimeve të mëparshme ndërkombëtare, përfshirë depolitizimin dhe rritjen e profesionalizmit të administratës zgjedhore.

Modernizimit të regjistrave të shtetasve dhe krijimit të një sistemi funksional adresash për gjithë vendin u kanë mbetur tashmë më pak dy vjet deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Që prej më shumë se gjysmë viti që nga prezantimi në fillim të këtij viti i projektit të asistencës të Prezencës financuar nga Komisioni Evropian në një vlerë prej 2,5 milionë Euro, Qeveria ka finalizuar planin e saj dhe ka filluar t'i caktojë burime specifike kësaj përpjekjeje. Duke pasur parasysh se puna konkrete veçse ka filluar, pjesa më e madhe e saj do të mbetet për t'u bërë në vitin 2008. Prezenca do të vazhdojë të këshillojë dhe të punojë për zgjidhje realiste dhe praktike, duke u mbështetur në gjithë burimet ekzistuese në vend, përfshirë edhe koordinimin e përmirësuar midis agjencive të ndryshme. Kjo do të mundësojë ecjen përpara edhe të një prej objektivave parësore të Qeverisë që lidhen ngushtë me këtë projekt – lëshimin e kartave të reja të identitetit dhe pasaportave. Viti i ardhshëm do të jetë shumë i rëndësishëm për lidhjen e modernizimit të gjendjes civile me lëshimin e kartave të identitetit dhe pasaportave – duke garantuar kështu besueshmërinë e të dhënave të identitetit, që ka për të qenë një çështje debati në zgjedhjet e ardhshme.

Përparimi i përgjithshëm në reformën e pronave varet nga legalizimi i ndërtimeve informale, ndërkohë që ecja përpara dhe përfundimi i kthimit dhe kompensimit mbetet një detyrim ligjor dhe domosdoshmëri politike. Regjistrimi i duhur i pronave të paluajtshme vazhdon të jetë një parakusht teknik për dy proceset e tjera. Prezenca ka këshilluar që të sinkronizohen legalizimi dhe regjistrimi fillestar i pronës dhe ajo mbetet e gatshme të ndihmojë më tej për zgjerimin dhe shumëfishimin e projektit pilot të 2007-ës. Ajo do të jetë gjithashtu e gatshme më tej për heqjen e kufizimeve mbi titujt e regjistruar të pronësisë, si dhe për ndërtimin e kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Duke pasur parasysh përmasat e problemeve mjedisore të vendit, një asistencë e mëtejshme e OSBE-së për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të drejtës për informim sipas Konventës së Aarhusit, mund të bëjë një dallim pozitiv. Decentralizimi i kompetencave, përfshirë menaxhimin e ujërave dhe mbetjeve, i lë hapësirë veprimit lokal, të cilin Prezenca do të vazhdojë ta mbështesë. Sigurimi i një asistence

domethënëse nga Prezenca për reformën administrative territoriale do të vazhdojë të varet nga nisja e kësaj reforme nga qeveria.

Forcimi i shtetit të së drejtës do të mbetet një nga qëllimet e përbashkëta të reformave në vend. Prezenca planifikon të punojë më tej për të ndihmuar në forcimin e etikës gjyqësore dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi, trajtimin e dëshmitarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjyq. Të drejtat e njeriut, përfshirë barazinë gjinore dhe situatën e minoriteteve, do të mbeten fusha të tjera ku do të ofrohet asistencë. Efektshmëria e prokurorisë, përfshirë standardet e saj profesionale dhe ndërveprimin me policinë dhe gjyqësorin, duke përmirësuar hartimin e akteve ligjore, përfshirë transparencën e tij, do të jetë një tjetër objektiv. Promovimi i vazhdimësisë së shërbimeve civile, paanshmëria dhe standardet profesionale mbeten gjithashtu objektiva të planifikuara.

Gjithashtu, roli i policisë në forcimin e shtetit të së drejtës do të mbetet i pazëvendësueshëm. Puna e Prezencës në trajnimin e policisë do të kontribuojë duke u përqendruar tek aftësitë dhe metodat investiguese, si edhe në kontrollin e kufirit tokësor. Veprimtaritë trajnuese dhe të natyrave të tjera të Prezencës, si p.sh. aspekti zbatues i anti-trafikimit, do të konsultohen ngushtë me ato të misionëve të tjera ndërkombëtare dhe do të jenë plotësuese të tyre.

Media shqiptare do të vazhdojë të kërkojë më shumë punë si në lidhje me standardet etike, ashtu edhe me ato profesionale. Prezenca ka në plan të asistojë më tej në të dyja fushat, si edhe në aspektet rregullatore të kalimit në transmetimet numerike. Shoqëria civile shqiptare do të përfitojë më shumë nga veprimtaria e Rrjetit Kombëtar të Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile të krijuara nga Prezenca në vitin 2004.